

Welcome to the
Future!



Shkollë e Gjuhëve

Prej 2004



PËRMBAJTJA

Mirësevini në New Age School	2
Parimet Themeltare	3
Filozofia Jonë Arsimore	4
Mësimdhënësit	5
Metoda Mësimore	6
Ambientet dhe Pajisjet Mësimore	6
Tekstet	7
Hapat e Procesit Mësimor	8
Kurset	9
Aktivitetet Jashtëmësimore	12
Klientët Institucionale	13
Përparësitë e New Age School	14
Nivelet e Kornizës të Përbashkët Gjuhësore Evropiane (CEFR)	14
Akreditimi nga EAQUALS	15

ADRESA

RR. AGIM RAMADANI , NR.30, PRISHTINË, KOSOVË
WWW.NEWAGESCHOOL.NET
INFO@NEWAGESCHOOL.NET
NAS_PRISHTINA@YAHOO.COM
TEL: + 381 (0) 38 246 100
CEL: +377 (0) 44 584 895 / +386 (0) 49 584 895

MIRËSEVINI NË NEW AGE SCHOOL

Sot, njohja e gjuhëve të huaja nuk është luks i një grupi të veçantë por domosdoshmëri e një shoqërie si e jona, e cila me këmbëngulje synon standardet evropiane.

Duke pasur parasysh këtë nevojë dhe aspiratë, si edhe nivelin e ulët të shkollave publike në Kosovë, por edhe të mrekulluar nga bukuria dhe madhështia e gjuhëve të huaja dhe kulturave që ato mbartin, ne në New Age School e kemi kthyer në mision tonin parhapjen e gjuhëve të huaja, duke ofruar metodologjinë, cilësinë dhe ambientet më të mira në vend.

E themeluar në 2004, New Age School është një shkollë private e gjuhëve që ofron kurse gjuhësore të përgjithshme dhe specifike në anglisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, frëngjisht dhe shqip, për të rritur dhe fëmijë.

Shkolla ndodhet në qendër të Prishtinës, shumë afër institucioneve më të rëndësishme të qytetit.

Ajo ka dy hyrje, para dhe prapa, dhe ofron parking të mjaftueshëm për studentët. 10 klasat e saj janë të ndërtuara në bazë të standardeve shkollore për 17 studentë secila dhe të pajisura me mjete moderne audio-pamore . Shkolla gjithashtu ofron një ambient komod të kompjuterizuar për mësues dhe nxënës si edhe internet falas. E gjitha shkolla është e klimatizuar dhe ka furnizim 24 orësh me ujë dhe rrymë. Programi ynë i mësimdhënies bazohet plotësisht në Kornizën e Përbashkët Gjuhësore Evropiane. (CEFR), sipas së cilës ofrohen 6 nivele: A1, A2, B1, B2, C1 dhe C2. Përpos kësaj, të gjitha aktivitetet e Shkollës bazohen në Rregulloren e shkollës, e cila është në përputhje të plotë me Rregulloren e EAQUALS (institucion evropian akreditues nga i cili shkolla jonë është akredituar prej vitit 2010).

PARIMET THEMELTARE

Duke qenë të ndërgjegjshëm për rëndësinë e misionit të shkollës si institucion dhe duke aspiruar për të qenë gjithmonë një shkollë e shkëlqyeshme, "New Age School" ka përcaktuar si gurthemel të saj këto parime kryesore.

NIVEL AKADEMIK SHEMBULLOR

Cilësia e pakonkurrent e mësimdhënies dhe programeve, ka qenë dhe do të jetë aspirata udhëheqëse e shkollës. Vetëm përmes përpjekjeve të përherëshme për të qenë bashkëkohore në mësimdhënie dhe programe do të mund t'u ofrojmë studentëve mundësinë për të përbushur dëshirat e tyre për dije dhe aftësim.

MORAL DHE KARAKTER TË PACENUAR

Ndonëse studentët në këtë shkollë kalojnë një pjesë jo të gjatë të ditës, ne synojmë që përmes shembullit të arsimitarëve dhe stafit tjetër, të ndërtojmë tek ta një sens kritik në të mësuar dhe të promovojmë përmes çdo aktiviteti të shkollës vlera morale universale.

PERSONEL SHEMBULLOR

Ne i konsiderojmë punonjësit tanë si boshtin e këtij institucioni. Prej arsimitarit dhe deri tek posti më modest ne synojmë të caktojmë individë shembullorë, të talentuar, me njohuri dhe përkushtim tepër të lartë.

PAJISJE MODEL

Synimet akademike të shkollës dhe studentëve do të mund t'i përbushim vetëm nëse ofrojmë ambiente dhe pajisje bashkëkohore. Për këtë arsye shkolla jonë mundëson dhe do të vazhdojë të mundësojë gjithmonë kushtet më të mira për një mësimdhënie të niveleve të larta.

NDJESHMËRI NDAJ PROBLEMEVE TË KOMUNITETIT

Shkolla e quan veten pjesë të komunitetit dhe si e tillë përpiqet ta ndihmojë komunitetin me të gjitha mundësitë e saj. Për vetë rrethanat historike dhe sociale në të cilat është ndodhur populli kosovar, ne e shohim si detyrim moral të tregohemi të gatshëm të ndihmojmë çdo individ apo grupim që për arsye financiare nuk mund të realizojnë dot aspiratat e tyre për shkollim.

RESPEKT NDAJ DIVERSITETIT

Duke e ditur se njohja dhe pranimi i kulturave të tjera nxit mirëkuptimin dhe drejtësinë shoqërore, shkolla jonë përkushtohet të jetë pionere në rrugën e respektimit të diversiteteve kulturore, etnike, gjinore, fetare dhe racore, jo vetëm brenda shkollës por edhe në çdo sferë tjetër të lidhur me aktivitetin e shkollës.



Standarde

Përkujdesje

Cilësi

FILOZOFIA JONË ARSIMORE

Në shkollën tonë studentët kanë mundësi të zhvillojnë njohuri e shkathtësi dhe të aftësohen për të komunikuar në mënyrë efektive dhe të përshtatshme në gjuhë të tjera. Aftësitë edhe njohuritë e tilla mund të arrihen vetëm nëpërmjet mësimi të gjuhëve të huaja.

GJUHA ËSHTË THEMELI I TË GJITHA MARRËDHENIEVE NJERËZORE

Të gjitha marrëdhëniet njerëzore bazohen mbi aftësinë e njerëzve për të komunikuar në mënyrë efektive me njëri-tjetrin. Mendimet tona, vlerat dhe të kuptuarit zhvillohen dhe shprehen nëpërmjet gjuhës. Mësimi i një gjuhe të huaj përfshin po ashtu edhe komunikimin me njerëzit me gjuhë krejt të ndryshme. Ky proces i lejon studentët të kuptojnë më mirë botën në të cilën ata jetojnë dhe të kontribuojnë në zhvillimin e perspektivave të tyre personale brenda ambientit global.

MËSIMI I GJUHËS SË HUAJ OFRON NJOHURI RRETH KULTURAVE TË TJERA

Studimi i gjuhëve të huaja siguron një dritare unike për të përfituar njohuri për kulturat e tjera. Mundësia për të përdorur gjuhën në mënyrë shoqërore dhe kulturore dhe për të komunikuar në mënyrë efektive kërkon të kuptuarit e koncepteve kulturore brenda asaj gjuhe.

TË GJITHË MUND TË MËSOJNË GJUHË TË HUAJA

Të gjithë personat e interesuar që vijnë në New Age School mund të arrijnë rezultate të knaqshme në procesin e të mësuarit të gjuhëve të huaja. Rezultatet janë gjithëpërfshirëse për të gjithë studentët dhe ato ofrojnë sfida intelektuale dhe kënaqësi.

MËSIMI I GJUHËVE TË HUAJA JEP MUNDËSI PËR NJOHURI TË REJA

DHE PËR TË ZHVILLUAR AFTËSITË E TË MENDUARIT

Të mësuarit e një gjuhë të huaj është një kontekst sfidues i të mësuarit i cili e rrit zhvillimin kognitiv tek studentët nëpërmjet inkurajimit të të menduarit analitik, kreativ dhe lateral. Përveç kësaj, mësimi i gjuhës së huaj ofron mundësi për zhvillimin e të menduarit kritik, negocimin, zgjidhjen e problemeve dhe vendimmarrjen.

BASHKËVEPRIMI DHE BASHKËPUNIMI NXITEN PËRMES MËSIMIT TË GJUHËS SË HUAJ

Përdorimi i gjuhës është një aktivitet shoqëror i cili u jep mundësi studentëve të rrisin shkathtësitë e tyre shoqërore duke punuar së bashku apo në grupe. Po të njëjtat shkathtësi mund të aplikohen edhe në fusha të tjera të të mësuarit.

MËSIMI I GJUHËVE TË HUAJA MUNDËSON NJË NIVEL MË TË LARTË TË TË KUPTUARIT TË VENDEVE TË TJERA EVROPIANE

Siç është vënë në dukje nga Këshilli i Evropës, shumëgjuhësia (dhe si rrjedhojë plurilingualizmi) nëpërmjet komunikimit efektiv ndërkombëtar nxit zhvillimin e mirëkuptimit të ndërsjellë, tolerancës, si dhe respektimit të identiteteve kulturore.

MËSIMI I GJUHËVE TË HUAJA NDËRTON THEMELET E SË ARDHMES

Mësimi i gjuhëve të huaja ndërtun një bazë të fortë për studentët për të ndjekur mësimin e gjuhës edhe pasi ata të largohen nga shkolla, si për shembull për studime të mëtejshme, punësim, udhëtime në kontekste familjare apo kënaqësi personale, etj.

MËSIMDHËNËSIT

Nuk ka dyshim se kualifikimi i mësuesve luan rol parësor në suksesin e studentëve. Në New Age School, kryesisht të gjithë mësuesit kanë shkollimin e shkallës BA në mësimdhënie të gjuhës dhe shumica prej tyre ndjekin studimet e shkallës master në edukim. Një numër i madh i tyre kanë kualifikime të avancuara në mësimdhënie apo fusha të ngjashme, përmes trajnimeve të ndryshme në Kosovë dhe jashtë vendit. Mësimdhënësit janë relativisht të rinj por me experiencë shumë pozitive në fushën e mësimdhënies, kanë rezultate të shquara akademike, krenari dhe pasionin për të punuar me studentë, integritet dhe etikë pune të pacenuar dhe kapacitet të lartë për avancime të mëtejshme profesionale. Aftësitë e larta profesionale të kombinuara me një qëndrim të ngrohtë dhe të dashur e veçojnë këtë trupë pedagogjike nga të tjerët. Të bindur se është nën përgjegjësinë tonë për t'u ofruar studentëve kushte dhe metodologji sa më të mira, New Age School ka strukturuar një program zhvillimor për personelin mësimdhënës, i cili fillon nga dita e parë e punës dhe vazhdon gjatë gjithë vitit. Personeli i ri duhet të kalojë nëpër një periudhë provuese dhe trajnim paraprak i cili vazhdimisht përcillet me monitorime, vlerësime dhe identifikime të nevojave. Trajnimet organizohen gjatë gjithë vitit bazuar në nevojat e stafit, duke bërë të mundur përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe përditësimin e njohurive metodologjike të mësuesve. Për të ndihmuar mësuesit dhe për t'u siguruar se procesi i mësimdhënies është në përputhje me standardet tona, mësuesit tanë monitorohen rregullisht nga drejtori mësimor dhe / ose drejtori i përgjithshëm. Po ashtu, monitorimet e rregullta në mes të kolegëve dhe sesionet e orëve studimore luajnë një rol shumë të rëndësishëm në këmbimin e përvojave dhe përmirësimin e cilësisë së njëri-tjetrit.



METODA MËSIMORE

Megjithëse kurrikula jonë e bazuar në CEFR nuk përkrah ndonjë metodologji të veçantë të të mësuarit të gjuhëve të huaja, parimet e CEFR-it inkurajojnë mësimdhënien me nxënësit në qendër dhe qasje të të mësuarit të gjuhës së huaj të bazuar në detyra. Ato po ashtu sugjerojnë që metodat që mësuesit zgjedhin në klasat e tyre të përshtaten me kontestin e mësimdhënies dhe atë shoqëror. Rrjedhimisht, ne kemi adaptuar një qasje të ekuilibruar me fokus në të folur, të dëgjuar, të lexuar dhe të shkruar, çdo herë duke vënë theksin në aftësimin e studentëve për të komunikuarit dhe jo për të njohur gjuhën në vetvete. Që nga themelimi i shkollës dhe deri tani ne kemi aplikuar metodologji dhe qasje të ndryshme, si për shembull: metodën audio-gjuhësore, metodën e reagimit gjithpërfshirës fizik, qasjen natyrale, metodën direkte, mësimdhënien gjuhësore komunikative, qasjen PPP (Prezantimi, Praktika, Prodhimi) dhe SIOP (Sheltered Instruction, Observation Protocol), etj. Cilëndo metodë që arsimtarët tanë e përdorin, ata me shumë kujdes mundohen të përfshijnë në të sa me shumë teknika dhe ushtrime, si për shembull: ushtrimet nxemëse, stuhinë e mendimeve, ushtrimet në role apo skeçe, bisedat apo intervistat në grup, krijimin e muraleve apo posterave, prezantime në power point, lojrat me fjalë dhe gjëegjëza, tregime me fotografi, kolazhe, etj. Me aplikimin e të këtyre metodave dhe teknikave, arsimtarët kanë mundësinë të zgjedhin një apo më shumë teknika që më së shumti i përgjigjen orës së tij/saj dhe kërkesave të studentëve.



AMBIENTET DHE PAJISJET MËSIMORE

Në New Age School mësimi zhvillohet në 10 klasa dhe të gjitha ato i përshtaten standardit kosovar për hapësira arsimore. Ndërtesa ka hyrje para dhe mbrapa dhe ofron hapësirë të mjaftueshme parkimi. Çdo dhomë është e ndërtuar në mënyrë që t'i sigurojë çdo studentin jo më pak se 2m². Ato të gjitha kanë ndriçim natyral dhe elektrik të shkëlqyer. E gjithë shkolla është e pajisur me ngrohje qendrore dhe ajër të kondicionuar. Shkolla po ashtu është krejtësisht e izoluar për të përballuar çdo ndryshim klimatik apo zhurmë që mund të vijë nga jashtë. Në qendër të shkollës ka një paradhomë me hapësirë të konsiderueshme që shërben për të shmangur rrëmujën e studentëve të cilët presin për të hyrë apo dalë nga mësimi. Aty studentët kanë qasje të lirë në internet përmes kompjuterave të vendosur në mure apo edhe mund t'i përdorin laptopet e tyre duke shfrytëzuar internetin pa tela të ofruar falas nga shkolla. Gjithashtu, në të njëjtën hapësirë arsimtarët dhe personeli tjetër kanë qasje në fotokopjen moderne e cila është çdo herë në shërbim të tyre. Po kështu ka dy hapësira për tualete me ventilim të duhur dhe ujë njëzetekatër orë. Ekziston edhe një dhomë e personelit e pajisur me raftë librash për studentët dhe mësues, si dhe një magazinë. Shkolla është e pajisur me alarme kundër vjedhjes dhe zjarrit. Ato monitorojnë gjithë hapësirën 24/7 dhe e bëjnë të mundur komunikimin e shpejtë me kompanitë e sigurimit, policinë dhe zjarrfikësit. Ndërtesa është e pajisur edhe me aparate kundër zjarrit dhe ka dy dalje emergjente. Në rastet e mungesës së energjisë elektrike, shkolla furnizohet nga një gjenerator që është në shërbim gjatë gjithë kohës. Klasat janë të dizajnuara për 17 studentë dhe të gjitha janë të pajisura me sistem audio-pamor, DVD, TV dhe kompjuter. Varësisht nga nevojat e arsimtarëve dhe studentëve, shkolla po ashtu siguron video projektor dhe skaner. Aktualisht, ne kemi filluar një projekt për t'u pajisur me tabela interaktive me anë të të cilave shpeshojmë të kemi një ndikim të madh në procesin e mësimdhënies dhe të nxëniet.



NEW AGE SCHOOL



TEKSTET

Të gjithë librat që përdorim janë përzgjedhur me kujdes duke u bazuar në propozimet e përfshira në Kornizën e Përbashkët Evropiane. Të gjithë janë botime të përditësuara të botuesve të njohur si Cambridge University Press, Oxford University Press, MacMillan, Baron's, Hueber, Mondadori, Hachette, etj. Të gjithë librat dhe materialet të tjera të shkruara që ne përdorim janë të përpiluara në përputhje me nivelet e CEFR- it. Programi mësimor i gjuhës për secilin nivel është i përzgjedhur me kujdes dhe vlerësohet të jetë i përshatshëm për moshat dhe nivelet e studentëve. Po ashtu, të gjithë librat janë të shoqëruar me dosjen gjuhësore e cila është e projektuar në formë të një përmbledhjeje të aftësive të arritura dhe punës së bërë gjatë kursit, po ashtu duke përfshirë edhe përshkruesit e aftësive për vetë-vlerësim. Kjo është shumë e rëndësishme për motivimin e studentëve, dhe në rastin e nxënësve të moshave të ulta dosja gjuhësore mund të shërbejë edhe si mjet komunikues në mes të arsimtarëve dhe prindërve për t'i informuar ata për planet mësimore dhe objektivat e përcaktuara për fëmijët e tyre. Pa marrë parasysh se çfarë niveli apo kursi është, materialet e kursit përmbajnë këto komponente:

Libri i Studentit

Libri është i ndarë në njësi të cilat ofrojnë materiale të mjaftueshme për orë aktive dhe tërheqëse. Tregimet dhe artikujt e përfshira janë nga temat më aktuale dhe interesante. Pas çdo njësie ka ushtrime që shërbejnë si përsëritje të mësimëve të mara deri atëherë. Çdo mësim përfshin një shumëllojshmëri të aktiviteteve interesante dhe motivuese, si: punë në dyshë, inskenime, lojra hamendësuese, tregime, etj; si dhe këngë dhe punë dore për çdo lloj moshe dhe niveli gjuhësor. Disa nga librat kanë një seksion gramatikor shumë praktik që mund të përdoret nga arsimtarët dhe studentët.

Libri Punës ose Aktiviteteve

Ky liber u mundëson studentëve ushtrime të mëtejme gramatikore dhe gjuhësore dhe u ndihmon t'i përvetësojnë edhe më mirë njohuritë e mara. Të gjithë materialet janë përpiluar me qëllim të përdorimit në klasë dhe ofrojnë mundësi për përsëritje apo për t'i ushtruar si detyrë shtëpie.

Audio CD-të

CD-të përmbajnë të gjitha materialet dëgjimore që u nevojiten arsimtarëve dhe studentëve për të dy librat, atë të studentit dhe të punës, për çdo nivel.

Materialet e Arsimtarit

Pakoja e Materialeve të Arsimtarit e cila përmbanë një numër të madh të aktiviteteve shtesë për secilin nivel, mund të jetë kopje elektronike dhe në letër. Ka shumë ushtrime që shërbejnë për të bërë përsëritje dhe fleta pune shtesë si dhe kartela ilustruese, të cilat e lehtësojnë dhe e bëjnë procesin e të nxëniet më të lehtë dhe ndihmojnë në përvetësimin e fjalorit në gjuhën e synuar.

Dosja Gjuhësore

Shumica e librave tanë posedojnë dosjen gjuhësore e cila është në përputhshmëri me udhëzimet e CEFR-it. Ajo i ndihmon studentët për të bërë vetëvlerësimin e njohurive të tyre, si edhe për të dokumentuar përparimin e tyre gjuhësor.

DVD-të

Një numër i madh i librave tanë, e posaçërisht ato të kurseve për fëmijë, posedojnë dokumentare apo seriale komike. Disa nga këto

DVD kanë edhe librin e aktiviteteve me ushtrime që ndihmon të përforcohet gjuha e paraqitur në librin e klasës.

Libri i arsimtarit

Ky liber posedon shënime mësimore për çdo mësim, skriptën e të gjitha pjesëve dëgjimore dhe përgjigjet e të gjitha ushtrimeve; përmban një pasqyrë të planprogramit për çdo nivel; ushtrimet shtesë si dhe ushtrimet vlerësuese. Ka po ashtu një numër të konsiderueshëm të materialeve të fotokopjueshme që i ofrojnë arsimtarit mundësi më të madhe për të bërë aktivitete plotësuese.

Materialet e tjera

Përveç teksteve të sipërpërmendura, shumica e librave posedojnë DVD interaktive, teste, kartela ilustruese, dhe letra vetëngjithëse. Ato nxisin studentët të hulumtojnë për informacione dhe ushtrime shtesë përmes webfaqeve të publikuara në faqet e internetit të shtëpive botuesve dhe janë veçanërisht të projektuara për të përforcuar gjuhën për çdo njësi.

Duke pasur parasysh faktin se qasja jonë metodologjike kryesisht përqendrohet në aftësimin e studentëve në të folur, do të thotë se ne duhet t'i përgatisim ata për t'u përballur me situata gjuhësore reale kur ata të dalin nga ambientet tona mësimore. Një nga mënyrat që ne përpilimi ta bëjmë këtë është duke prezantuar materiale autentike në mesimet tona. Përdorimi i materialeve të tilla të mara kryesisht nga interneti, revistat apo gazetat u jep mundësi studentëve të ekspozohen më shumë ndaj gjuhës reale të përdorur në kontekste reale.



HAPAT E PROCESIT MËSIMOR

Në jemi të vetëdijshëm se çdo student mëson në mënyra të ndryshme dhe se egzistojnë shumë faktorë që ndikojnë në procesin e të nxenurit të një gjuhe të huaj, si moshë, gjinia, kultura, motivimi, përvoja gjuhësore dhe stili i të mësuarit. Për t'u siguruar që studentët tanë po i arrijnë synimet e përcaktuara, ne kemi modeluar një proces të të nxënësve që kalon nëpër këto etapa.

Vlerësimi i Nivelit

Kur studentit vjen për herë të parë në shkollën tonë, ai duhet t'i nënshtrohet një testimi pranues i cili do saktësojë nivelin e tij gjuhësor. Ky test ka për qëllim të vlerësojë nivelin gramatikor, shqiptimin, të lexuarit, të shkruarit, të dëgjuarit dhe të folurit, si dhe fjalet që ai njeh. Nëse studenti ka një certifikatë të lëshuar nga ndonjë shkollë tjetër, ne mund ta marrim atë në konsiderat vetëm në qoftë se programi i atij institucioni është në përputhshmeri me CEFR.

Përcaktimi i Kursit dhe Nivelit

Edhe kur studentit i është caktuar niveli pas testit pranues, ai do të monitorohet nga arsimtari i klasës gjatë gjithë javës së parë ku dhe do të kenë kohë dhe hapsirë të diskutojnë në detaje në lidhje me atë se çfarë ai do të arrijë përmes kursit. Pasi që mësuesi të ketë identifikuar qëllimet e studentit, profilin e tij të të mësuarit dhe sfondin gjuhësor, ai përfundimisht e përcakton nivelin dhe kursin e studentit.

Progresi

Studentët tanë vlerësohen dhe testohen rregullisht në mënyrë që të kontrollohet progresi i tyre. Pas çdo testimi studentëve u jepen sqarime në lidhje me përpunimin e tyre dhe ushtrime në formë të përsëritjeve me qëllim të përmirësimit të njohurive të tyre. Studentët po ashtu këshillohen nga arsimtarët të bëjnë ushtrime nga materiale shtesë dhe u tregohet se si të ushtrorjnë që të përmirësohen aftësitë e tyre gjuhësore brenda dhe jashtë klase. Nëse studenti për ndonjë arsye nuk i arrin objektivat e kursit, ne punojmë me të duke rishikuar planin mësimor apo, nëse është e nevojshme, i ofrojmë edhe mundësinë që të ndërrojë nivelin.

Rezultati Përfundimtar

Në përfundim të çdo kursi studentët marrin një Certifikatë të Përfundimit të Kursit, e cila detajton nivelin e tyre gjuhësor në përputhje me nivelet CEFR, duke cekur përshkruesit e aftësive sipas shkallëzimit global CEFR për çdo nivel. Nxënësit mund ta përdorin këtë dokument si një dëshmi gjuhësore në aplikimet për shkollim, për punë, etj.

Zhvillimi pas Kursit

Duke ditur dhe shpresuar së mësimi i gjuhës nuk përfundon kurrë, para se studentët të largohen nga shkolla jonë, ne u ofrojmë udhëzime se si të vazhdojnë avancimin e aftësive të tyre gjuhësore në të ardhmen. Zhvillimi i vazhdueshëm është një nga arsyet që ne i inkurajojmë studentët për të mbajtur shënime për progresin e tyre në dosjet e tyre gjuhësore (si p.sh. Dosja Gjuhësore Evropiane).



CERTIFIKATAT

Certifikata e Përfundimit të Kursit, e cila jepet pas përfundimit të kursit dhe provimit përfundimtar, përmban informata mbi nivelin dhe rezultatin që studentit ka arritur.

Certifikata e vijueshmërisë jepet në rast se studentit nuk ka arritur ta përfundojë krejtë nivelin apo nuk ka dashur t'i nënshtrohet provimit përfundimtar. Kjo lloj certificate jepet edhe në fund të Kursit Përgatitor të Provimeve Ndërkombëtare. Në të deklarohen orët e mbajtura dhe niveli i vijuar.

Për ata që duan të bëjnë testimin e njohurive të tyre të përgjithshme gjuhësore pa ndjekur ndonjë nivel apo kurs, ne ofrojmë Provimin e Njohurive Gjuhësore. Pasi ta ketë kaluar provimin dhe marrë notën në bazë të sistemit vlerësues të lartpërmendur, aplikanti merr **Certifikatën e Njohurive Gjuhësore** ku ceket niveli sipas CEFR.

KURSET

Në New Age School ofrohen kurse gjuhësore për të rritur dhe fëmijë. Regjistrimi është i hapur gjithë vitin dhe kurset fillojnë thuajse çdo javë. Ne ofrojmë kurse në shumë gjuhë dhe për qëllime të ndryshme. Tabela në vijim përmban të gjitha kurset sipas gjuhës, llojit të kursit, dhe moshës së studentëve.

GJUHA	KURSI						MOSHA		
	E përgjithshme	Biznesi	Gramatike	Qëllime Specifike	Qëllime Akademike	Përgatitje për Provime	7-11 vjeç	12-15 vjeç	Të Rritur
Anglisht	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Gjermanisht	✓					✓			✓
Italisht	✓					✓			✓
Frëngjisht	✓					✓			✓
Spanjisht	✓					✓			✓
Shqip	✓								✓

Numri i orëve javore dhe, rrjedhimisht kohëzgjatja e secilit kurs varet nga orari i zgjedhur nga studenti. Oraret që ne ofrojmë janë:

- Kurs i rregullt: 6 orë javore
- Kurs intensiv: 10 orë javore
- Kurs super intensiv: 20 orë javore
- Kurs i personalizuar: orari përcaktohet sipas nevojave të studentit

Grupet zakonisht përbëhen nga 10 ose 12 studentë.

Në raste të caktuara bazuar në kërkesat e studentëve, ky numër mund të rritet, por asnjëherë më shumë se 17. Po kështu, ne ofrojmë kurse në grupe të vogla (grupe VIP), si edhe kurse individuale.

ORËT MËSIMORE

Ndonëse nuk ka një përgjigje të vetme dhe përfundimtare për pyetjen se sa orë nevojiten për të arritur një nivel të caktuar, në New Age School ne zbatojmë udhërrëfyesin e Universitetit të Kembrixhit mbi orët e mbikqyrura mësimore:

CEFR	Orët e Mbikqyrura Mësimore
A2	rreth 180-200
B1	rreth 350-400
B2	rreth 500-600
C1	rreth 700-800
C2	rreth 1,000-1,200



ANGLISHTE PËR TË RRIKUR

Niveli i CEFR Niveli i New Age School Orët Mesimore

ANGLISHTE E PËRGJITHSHME			
A1	Fillestar	84	
A1+	Elementar	120	
A2	I Mesëm i Ulët	120	
B1	I Mesëm	144	
B2	I Mesëm i Lartë	144	
C1	I Avancuar	144	
C2	Ekspert	250	

Duke qenë të vetëdijshëm se studentët kane nevoja dhe profile të ndryshme, vendosja e studentit në qendër të mësimit na mundëson që të plotësojmë kërkesat gjuhësore të secilit student. Kurset tona ofrojnë praktikim të të katër aftësive kryesore: leximit, shkrimit, të folurit dhe të shkruarit. Sidoqoftë, programi i Anglishtes së Përgjithshme fokusohet në komunikim.

ANGLISHTE BIZNESI			
A2	Elementar	120	
B1	I Mesëm i Ulët	120	
B1+	I Mesëm	144	
B2	I Mesëm i Lartë	144	
C1	I Avancuar	144	
C2	Ekspert	250	

Komunikimi i suksesshëm është thelbesor në ambientin e sotëm të konkurrencës të biznesit. Përmes programit të Anglishtes së Biznesit ne ju mundësojmë një përgatitje të shkëlqyer për të bërë biznes ndërkombëtar. Mësimet ndërthurin të gjitha aftësitë gjuhësore si edhe kombinime ushtrime të fjalorit, diskutime, raste studimore dhe inskenime. Aftësitë komunikuese përfshijnë: takime, negociime, prezantime, telefonim, si edhe emaila, letra dhe memo.

GRAMATIKË E ANGLISHTES			
A2	I Mesëm i Ulët	120	
B1	I Mesëm	144	
B2	I Mesëm i Lartë	144	
C1	I Avancuar	144	
C2	Ekspert	250	

Ky program është hartuar enkas për të plotësuar nevojat e studentëve dhe mësuesve të ardhshëm për të forcuar konceptet gramatikore të mësuara më herët. Ky kurs do të ishte plotësues i shkëlqyer i Anglishtes së Biznesit, AQS dhe AQA.

ANGLISHTE PËR QËLLIME SPECIFIKE			
A1	Fillestar	84	
A1+	Elementar	120	
A2	I Mesëm i Ulët	120	
B1	I Mesëm	144	
B2	I Mesëm i Lartë	144	
C1	I Avancuar	144	
C2	Ekspert	250	

AQS është bërë një nga drejtimet më të dalluara të Anglishtes si Gjuhë e Huaj. Ky program ofron kurse specializuete të Anglishtes për Punë, Anglishtes Juridike, Anglishtes për Turizëm, Anglishtes për Marketing, Anglishtes për Informatikë, etj. Këto kurse fokusohen në aktivitete gjuhësore në lidhje me gramatiken, fjalorin, stilin, teknikat e të mesuarit dhe komunikimin.

ANGLISHTE PËR QËLLIME AKADEMIKE			
B1	Niveli i Parë	144	
B2	Niveli i Dytë	144	
C1	Niveli i Tretë	144	
C2	Niveli i Katërt	250	

Programi ynë AQA i ndihmon studentët të cilët përgatiten për studime universitare të përdorin një gjuhë të pershtatshme akademike. Ky program fokusohet në aftësitë e nevojshme për të pasur sukses në një ambient studimor anglishtfolës dhe shumëlingor, që zakonisht ndeshet në studimet universitare.

Niveli i CEFR Niveli i New Age School Orët Mesimore

12-15 VJEÇARE			
A1	Niveli i Parë	96	
A2	Niveli i Dytë	96	
A2+	Niveli i Tretë	96	
B1	Niveli i Katërt	96	

Duke pasur parasysh rëndësinë që ka përvoja e parë e mësimit të gjuhës tek fëmijët, mësuesit dhe prindërit duhet jenë shumë të kujdesshëm kur të zgjedhin kursin e duhur për fëmijë apo adoleshentë. New Age School ofron kurse të Anglishtes duke filluar nga moshat 7 vjeçare. Fëmijët dhe adoleshentët deri në 15 vjeç mund të mësojnë në grupe speciale me mësues të kualifikuar posaçërisht për këto moshë. Librat, materialet audio-pamore dhe lojërat e hartura enkas, mundësojnë një proces të thjeshtë dhe argëtues të të mesuarit.

7-11 VJEÇARE			
	Niveli i Parë	96	
	Niveli i Dytë	96	
A1	Niveli i Tretë	96	
A1+	Niveli i Katërt	96	
A2	Niveli i Pestë	96	
A2+	Niveli i Gjashtë	96	

AKTIVITETET JASHTËMËSIMORE

Studentët përfitojnë prej aktiviteteve jashtëshkollore në mënyrë të jashtëzakonshme. Sipas hulumtimeve të fundit fëmijët që marrin pjesë në programe jashtë mësimi janë më aktivë dhe kanë qëndrim më pozitiv ndaj mësimi, arrijnë rezultate më të larta dhe përfytyrojnë një ndjenjë më të lartë të përbushjes, kompetencës dhe vetëvlerësimit. Shfaqjet teatrale, Ulësja e Shkrimtarit, organizimet festive, Konkursi i Gërmëzimit, netët e filmit, ceremonitë e diplomimit, udhëtimet jashtë vendit dhe shumë aktivitete të tjera vijnë tek studentët si sfida të mrekullueshme për të mësuar dhe për t'u argëtuar.

• Shfaqjet Skenike

Në New Age School nxënësit kanë mundësinë e madhe ta përfytyrojnë gjuhën edhe përmes dramave dhe shfaqjeve skenike. Pjesët e mirënjohuar si "E përhitura", "Pinoku", etj. shfaqen në anglisht prej nxënësve tanë të vegjël në teatrin Dodona. Shikuesit dhe prindërit i përfytyrojnë këto shfaqje si arritje të mëdha dhe përvoja të paharrueshme për ta dhe fëmijët e tyre.

• Konkursi i Gërmëzimit


Studentët kanë mundësi t'i ballafaqojnë aftësitë e tyre gërmëzuese në Konkursin e Gërmëzimit. Shumë studentë duan të marrin pjesë në këtë konkursim ku dëshira për të fituar është e madhe.

• Ulësja e Shkrimtarit

Studentëve që duan të ndajnë me të tjerët veprat e tyre, u kushtohet kohë dhe vend i veçantë. Pasi i kanë redaktuar dhe rishikuar veprat e tyre, në aktivitetin Ulësja e Shkrimtarit ata kanë mundësi të marrin mendimet e shokëve të tyre për to. Studentët e ulur në Ulësen e Shkrimtarit lexojnë pjesë të zgjedhura para bashkëmoshatarëve të tyre dhe më pas marrin mendimet e tyre në lidhje me atë që kanë shkruar. Përmes këtij aktiviteti, krahas praktikimit të gjuhës, ata zhvillojnë ndjenjen e autorësisë dhe krijimtarisë si edhe frymën e debatit dhe kritikës në grup.

• Organizimet Festive në NAS

Mësuesit tanë kanë kuptuar se organizimet festive ndihmojnë jashtëzakonisht shumë në shoqërimin e studentëve dhe ndikojnë pozitivisht që ata të mos i braktisin kurset dhe ta shohin shkollën tonë si vend të përkryer për të mësuar, për t'u shoqëruar dhe argëtuar. Çdo aktivitet festiv i ndihmon të përmirësojnë gjuhën dhe të shoqërohen me moshatarët e tyre. Disa prej këtyre festimeve bëhen me rastin e Ditës së Falënderimeve, Ditës së Shtrigave, Festave të Fundvitit, Ditës së Mësuesit, Festës së Flamurit, etj.



• Netët e Filmit

Si profesionistë progresistë gjithmonë në kërkim të mjeteve, qasjeve, teknikave dhe metodave të ndryshme për të zgjeruar repertorin e mësimdhënies, shpesh, nuk na duhet të hulumtojmë larg ambienteve të mësimin për t'u inspiruar. Një burim i përhershëm i gjuhës autentike janë edhe filmat. Mësimi përmes filmave është efikas, i shpejtë dhe një mënyrë shumë e mirë për të përmirësuar aftësitë gjuhësore. Në New Age School netët e filmit organizohen sipas moshës dhe niveleve dhe përzgjedhja e filmave bëhet në mënyrë të tillë që të përfshihen sa më shumë tema.

• Udhëtime Jashtë Vendit

Këto udhëtime krijojnë mundësi që studentët të përjetojnë sfida dhe aktivitete që i kapërcejnë mundësitë e mësimin në klasë. Përmes këtyre 'aventurave' pjesëmarrësit zgjerojnë horizontin, ndërkohë që fitojnë aftësi të reja, përmirësojnë aftësitë e punës në skuadër si edhe mposhtin drojën duke bashkëpunuar në një ambient të huaj por të sigurt dhe argëtues. Ne besojmë se largimi prej familjes për disa ditë u mundëson studentëve një tjetër formë të të mësuarit, çka nuk mund të arrihet në mjedisin e tyre. Kur kthehen studentët përjetojnë më shumë vetbesim, përgjegjshmëri, dhe dëshirë për eksperiencë të reja.



Klientët Institucionalë

Klientët tanë kryesorë institucionalë janë :

- Zyra e Presidentit të Kosovës
- Ministria e Energjisë dhe Minierave
- Ministria e Shërbimeve Publike
- Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit
- Ministria e Ekonomisë dhe Financave
- Forca e Sigurisë të Kosovës
- Ministria për Komunitete dhe Kthim
- Ombudsperson i Kosovës
- Banka Qendrore e Kosovës
- Procredit Bank
- United Nations Development Programme - UNDP
- Handicap People of Kosovo
- Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit - ART
- Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës
- Enti i Statistikës së Kosovës
- KFOR
- Instituti i Kosovës për Administratë Publike
- Agjencioni Europian për Rindërtim
- Galeria e Arteve të Kosovës
- Hope and Homes for Children
- IPKO
- Qendra Kosovare për Studime Gjinore
- UNICEF



PËRPARËSITË E NAS

- anëtare e akredituar e Asosacionit Evropian për Shërbime Gjuhësore Cilësore - EAQUALS;
- program mësimor të me kurse dhe nivele të bazuara në Kornizën e Përbashkët Gjuhësore Evropiane;
- mësues të trajnuar për të zhvilluar orë mësimore në qendër të së cilës janë studentët dhe tek kërkemat dhe qëllimet e tyre. NAS ka një program të aftësimiit dhe trajnimit të mësuesve dhe i nxit e i përkrah ata në zhvillimin e aftësive të tyre mësimdhënëse;
- shkollë e cila punon në bazë të një Kodi Etik, i cili siguron cilësi, standarde, dhe mbrojtje të klientit;
- standarde të larta të mësimdhënies - ne pranojmë vetëm arsimtarë ambiciozë, të cilët përzgjidhen me kujdes dhe trajnohen vazhdimisht;
- personel i përgatitur për të ofruar shërbime fleksibël dhe të efektshme ;
- përkushtim për monitorimin dhe përmirësimin e shërbimit. Për këtë qëllim NAS ka hartuar një skemë të vetën të vlerësimit dhe sistem të menaxhimit të cilësisë;
- aktivitete shoqërisht dhe program udhëtues;
- lokacion atraktiv;
- çmime konkurruese;
- pajisje dhe mjete moderne - internet pa tela, sallë filmash, video projektor, pajisje audio-vizuale, bibliotekë për studentët dhe mësuesit;
- klasa të ndërtuara enkas për të akomoduar deri në 17 studentë dhe të pajisura me mjete moderne audio-pamore;
- ambiente shkollore të projektuara enkas dhe pajisje moderne;
- shkolla e klimatizuar me ngrohje qendrore dhe ajër të kondicionuar;
- rrymë dhe ujë 24 orë;

NIVELET E KORNIZËS TË PËRBASHKËT GJUHËSORE EVROPIANE

Korniza e Përbashkët Gjuhësore Evropiane: Të Mësuarit, Mësimdhënia, Vlerësimi, shkurtimisht CEFR, është një udhëzues që ndihmon për të matur arritjet e nxënësve të gjuheve të huaja në të gjithë Evropën. Ajo është hartuar nga Këshilli i Evropës si thelb i projektit "Language Learning for European Citizenship" mes 1989 dhe 1996.

- A1 Mund të kuptojë dhe përdorë shprehje të njohura të përditshme dhe shprehje shumë të thjeshta që kanë për qëllim përbushjen e nevojave të një lloji konkret. Mund të paraqesë veten dhe të tjerët dhe mund të pyesë e përgjigjet në lidhje me të dhënat personale të tilla si, ku jeton, njerezit që njeh dhe sendet që ka. Mund të bashkeveprojë në mënyrë të thjeshtë me kusht që bashkëbiseduesi të flase ngadalë dhe të jetë i gatshëm për të ndihmuar.
- A2 Mund të kuptojë fjalë dhe shprehje të shpeshta në lidhje me aspektet imediate (p.sh. informacione shumë të thjeshtë personal, blerje, gjeografi lokale, punësim). Mund të komunikojë në detyrë të thjeshta dhe rutine që kërkojnë një shkëmbim të thjeshtë dhe të drejtëpërdrejtë të informacionit mbi çështje të njohura dhe rutinore. Mund të pershkruaje me fjale të thjeshta aspekte të së kaluarës të vet, të mjedisit të ngushtë dhe nevojave të menjëhershme.
- B1 Mund të kuptojë pikat kryesore të të dhënave standarde për temat e njohura që hasen në punë, shkollë, kohën e lire, etj. Mund të zgjidhë shumë situata që lindin gjatë udhëtimit në një zonë ku flitet kjo gjuhë. Mund të prodhojë tekste të thjeshtë e të lidhur për temat të njohura ose të interesit personal. Mund të pershkruaje përvojë dhe ngjarje, endrra, shpresa dhe ambicie dhe shkurtimisht të japë arsye dhe shpjegime për mendime dhe plane.
- B2 Mund të kuptojë idetë kryesore të një teksti të ndërlikuar si rreth temave konkrete ashtu dhe abstrakte, përfshi edhe diskutime teknike në fushën e vet të specializimit. Mund të ndarveprojë deri diku rrjedhshëm dhe spontanisht oka e ben ndarveprimin e rregullit me folësit amëtare mjaft të mundshëm, pa tendosje për asnjërin palë. Mund të prodhojë tekste të qarta e të hollësishme mbi një game të gjërë temash dhe të shpjegojë një këndvështrim mbi një çështje të caktuar duke i dhënë përparësi dhe mangësi e alternativave të ndryshme.
- C1 Mund të kuptojë një game të gjërë tekstesh të veshtirë dhe më të gjatë, dhe të dallojë nenkuptimet. Mund të shprehë veten rrjedhshëm dhe spontanisht pa u menduar dukshëm për shprehjet e duhura. Mund të përdorë gjuhën në mënyrë fleksibël dhe të efektshme për qëllime shoqërore akademike dhe profesionale. Mund të prodhojë tekste të qarta, të mirë-strukturuara dhe të hollësishme mbi tema të ndërlikuara, duke treguar përdorim të kontrolluar të modeleve organizative, lidhësive dhe mjeteve gjuhësore kohezive.
- C2 Mund të kuptojë me lehtësi praktikisht gjithçka degjon apo lexon. Mund të përmbledhë informacione nga burime të ndryshme të folura dhe të shkruara, duke rindërtuar argumente rrefime në një prezantim koherent. Mund të shprehë veten spontanisht, shumë rrjedhshëm dhe saktësisht, duke dalluar ngjyrimet të lehta kuptimore edhe në situatat më komplekse.

AKREDITIMI NGA EAQUALS

Nga gushti i vitit 2010, New Age School është bërë anëtare e akredituar nga EAQUALS-Shoqata Evropiane për Shërbime Gjuhësore Cilësore, e cila ofron të vetmin standard evropian gjërisht të pranuar në fushën e mësimit të gjuhës.

EAQUALS është një organizatë ndërkombëtare që promovon dhe garanton cilësi në të mësuarit dhe të nxëniet e gjuhës. Kjo organizatë bënë certifikimin e cilësisë kur institucionet përmbushin standardet e larta gjatë Inspektimit.

Institucionet anëtare të akredituara përkushtohen për përsoshmëri dhe zhvillim akademik të vazhdueshëm i cili rregullisht vërtetohet nga EAQUALS nëpërmjet inspektimeve. EAQUALS ka më shumë se 100 anëtarë të akredituar në më shumë se 20 vende.

Lista e anëtareve të akredituar dhe të asociuar përfshin institucione si: British Council, Cambridge ESOL, Goethe Institut, Trinity College, Bell Educational Trust, Eurocentres, etj. Të jesh anëtare e akredituar nga një agjensi si kjo është privilegj dhe përgjegjësi e madhe.

CERTIFICATE OF ACCREDITATION

This is to certify that

New Age School

is accredited by



EXCELLENCE IN LANGUAGE EDUCATION

European Association for Quality Language Services,

and has become an Accredited Member of the Association, having demonstrated its full compliance with all the EAQUALS Quality Standards.

The EAQUALS inspection was carried out in October 2009 and accreditation and membership is valid until
30 September 2013.

Ludka Kotarska
Chair

Ania Kolbuszewska
Director of EAQUALS Accreditation and Consultancy Services